



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALLAKASTËR

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE JURIDIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
SEKTORI JURIDIK

Nr. 794 Prot.

Ballsh, më 22.02.2024

PROJEKT-VENDIM

NR. 08 DATË 22.02.2024

PËR

**DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 58, DATË 30.11.2023 TË KËSHILLIT BASHKIAK
“PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE TË BURSAVE PËR NXËNËSIT QË
NDJEKIN VITIN E PARË NË SHKOLLAT E MESME TË ARSIMIT PROFESIONAL
PËR VITIN SHKOLLOR 2023-2024”**

-KËSHILLIT TË BASHKISË

Në zbatim të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”, ndryshuar, Ligjit 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, VKM-së nr.666, datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar, si dhe format e tjera të perkujdesjes ndaj kategorive të veçanta në institucionet arsimore parauniversitare publike”, e ndryshuar, të vendimit nr. 60, datë 20.02.2024 “Për miratimin e shtyrjes së afatit të miratimit të vendimeve për bursat e nxënësve të arsimit profesional, në Këshillin Bashkiak Mallakastër”,

PROPOZJ:

1. Pas pikës 1.2 të vendimit nr. 58, datë 30.11.2023 të Këshillit Bashkiak Mallakastër shtohet pika 1.3 , me këtë përmbajtje:
Miratimin e bursës për nxënësit që ndjekin mësimin në shkollat e mesme të arsimit profesional në institucionet arsimore publike për vitin mësimor 2023-2024, sipas tabelës më poshtë:

Nr.	Emër/Atësi/Mbiemër	Vendbanimi	Shkolla	Kriteri i përfitimit të bursës	Bursa
1	Geraldo Viktor Ymeraj	Ballsh	SH.M. Profesionale "Petro Sota", dega Teknologji informacioni dhe komunikim, Fier	Pa të ardhura	E plotë
2	Bule Hetem Barjamaj	Drenovë	SH.M. Profesionale "Petro Sota", dega Naftë, Fier	Degë parësore	E plotë
3	Antonio Luan Sulaj	Anëbreg	SH.M. Bujqësore "Rakip Kryeziu", dega Veterinari, Fier	Degë parësore	E plotë
4	Përparim Foti Jançaj	Belishovë	SH. e Mesme Tregtare "Pavarësia", dega Hoteleri-Turizëm, Vlorë	Pa të ardhura	E plotë

Kjo listë mbyllet me nr. rendor 4 (katër).

Konceptoi: A.Heqimaj

Pranoi: N.Sakaj

Miratoi: L.Saliaj

KRYETAR

Qerim Ismailaj

